



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:093227

Datë: 17.05.2023

Numri i dokumentit: 04289310

Pml.nr.208/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKAT SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit N.K, për shkak të veprave penale: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.1 të KPRK-së, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe konflikti i interesit nga neni 417 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurit, avokatët Virtyt Ibrahimaga dhe Taulant Ferizi, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PPPS.nr.20/2023 të datës 20.04.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN1.S.nr.71/2023 të datës 05.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.05.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e përbashkët e mbrojtësve të pandehurit N.K për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti Special PPPS.nr.20/2023 të datës 20.04.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN1.S.nr.71/2023 të datës 05.05.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin PPPS.nr.20/2023 e datës 20.04.2023, të pandehurit N.K, i ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale: keqpërdorimi i pozitës apo

autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.1 të KPRK-së, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe konflikti i interesit nga neni 417 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi të pandehurit do t'i zgjasë deri më datë 19.05.2023. Të pandehurit paraburgimi i është caktuar konform dispozitës së nenit 184 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.1.1, 1.2.2 e 1.2.3 të KPPRK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN1S.nr.71/2023 e datës 05.05.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit N.k, dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë. Po me të njëjtin aktvendim ka gjetur se ndaj të pandehurit qëndron baza për caktimin e paraburgimit sipas nenit 184 par.1 nënpar.1.1 pika 1.2.2 të KPP-së, ndërsa sa i përket pikës 1.2.1 e 1.2.3 nga neni 184, në rastin konkret për të pandehurin nuk ekzistojnë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësit e të pandehurit N.K, avokatët Virtyt Ibrahimaga dhe Taulant Ferizi, nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal të KPPK-së, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPK-së, dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën, t'i anulojë aktvendimet e atakuara dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, apo aktvendimet e atakuar t'i ndryshoj, ashtu që të pandehurit t'i ndryshoi masën e paraburgimit duke ia zëvendësuar me ndonjë masë tjetër më të lehtë nga neni 171 të KPP-së.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.87/2023 e datës 16.05.2023, ka propozuar që kërkesa e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të pandehurit N.K, avokatët Virtyt Ibrahimaga dhe Taulant Ferizi, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësit e të pandehurit në kërkesën e tyre pretendojnë se aktvendimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat e përcaktojnë bazën e caktimit të paraburgimit, ngase caktimi i paraburgimit nuk është mbështetur në prova dhe në aktvendimet e kundërshtuar fare nuk janë dhënë arsye të qarta dhe bindëse për faktet vendimtare mbi dyshimin e bazuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën është duke u hetuar. Gjithashtu, nuk janë plotësuar kushtet ligjore konform dispozitës së nenit 184 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP-së, Po ashtu, duke u bazuar në praktiken gjyqësore të nenit 5 të GJEDNJ dhe në nenin 31 e 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës heqja e lirisë mund të bëhet vetëm kur ka shkaqe dhe arsye të bazuara qartë se personi ka kryer veprën penale, andaj, mbrojtja thekson se edhe me masa tjera më

të buta mund të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë. Andaj, mbrojtja thekson se edhe me masa tjera më të buta mund të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë, drejtë kanë vlerësuar dyshimin e bazuar se i pandehuri N.K ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë sepse me datë 26.01.2023 ka lidhur kontratë të dëmshme në kundërshtim me ligjin e Prokurimit Publik duke e urdhëruar me shkrim shefin e prokurimit Y.D. që ta nënshkruan këtë kontratë për kundër rekomandimit të KRPP, në bazë të të cilit tenderi duhej të rivlerësohej dhe të shpallet tender i hapur, në vlerë prej 60.000 euro, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës dhe përfitim të kundërligjshëm operatorit ekonomik, me çka janë plotësuar kushtet për caktimin e paraburgimit bazuar në dispozitën e nenit 184 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së për caktimin e paraburgimit. Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 184 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP-së, sepse me gjetjen e të pandehurit N.K në liri, ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprave penale, duke ndikuar në dëshmitarët të cilët kanë njohuri lidhur me rastin si A.Sh., Y.D., R.B., S.I., E.T., etj., pasi që njëjtë nuk janë dëgjuar ende nga ana e Prokurorisë, sepse shumicën e dëshmitarëve i njihen ngase punojnë në të njëjtin vend të punës, me qëllim të koordinimit të deklaratave të tyre në favor të mbrojtjes, ashtu që në këtë mënyrë i pandehuri po të lihet duke u mbrojtur në liri të plotë, i njëjti do të mund të pengonte rrjedhën normale të procedurës penale.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësve lidhur me shkeljen e neneve të KEDNJ dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, po ashtu janë të pabazuara ngase procedura penale është në fillimin e saj, të pandehurit i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i pandehuri është privuar nga liria për rastet e parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, dhe kundër të pandehurit është duke u zhvilluar një procedurë penale dhe ajo deri në përfundim të kësaj procedure presumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia eventuale e tij.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 171 të KPP-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.208/2023, më datë 16.05.2023

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi